

## PRANIMI NË SPITAL PËR KONTROLLIM

(Paragrafi 2 i Aktit për Shëndetin Mendor 1983)

1. Emri i pacientit	
2. Emri i personit përgjegjës për kujdesin tuaj ( "klinikisti përgjegjës")	
3. Emri i spitalit dhe pavijonit	

### Përse jam në spital?

Ju mbaheni në këtë spital sipas paragrafit 2 të Aktit për Shëndetin Mendor 1983. Juve ju kanë ekzaminuar dy mjekë dhe ata mendojnë se ju keni çrregullim mendor dhe duhet të rriini në spital në mënyrë që personi përgjegjës për kujdesin tuaj (klinikisti i juaj përgjegjës) e zbulon problemin tuaj dhe si mund t'ju ndihmoj.

### Sa kohë do të jem këtu?

Ju mund të mbaheni këtu deri në 28 ditë.

Gjatë kësaj kohe ju nuk duhet të dilni, përveç nëse klinikisti i juaj përgjegjës ju thotë se mund të dilni. Nëse provoni të dilni nga spitali stafi mund t'ju ndaloj, dhe nëse dilni ata mund t'ju kthejnë mrapsh.

Nëse tashmë jeni mbajtur në spital sipas paragrafit 4 të Aktit për Shëndetin Mendor, atëherë kjo llogaritet si pjesë e qëndrimit tuaj 28 ditësh.

Në rastin tuaj 28 ditë përfundojnë më:

Data:

## Çfarë ndodhë më tutje?

Klinicisti i juaj përgjegjës ju tregon nëse mendon se ju jeni në gjendje të mire që të dilni nga spitali. Kjo mund të ndodhë në çdo kohë gjatë 28 ditëve.

Klinicisti i juaj përgjegjës vendos nëse ju duhet të qëndroni në spital më shumë se 28 ditë, meqë rast ju mund të mbaheni në spitalin sipas paragrafit 3 të Aktit për Shëndetin Mendor. Ata duhet të marrin këtë vendim para se të skadojnë 28 ditë. Nëse ndodhë kjo, juve do t'ju jepin një fletëpalosje tjetër për t'ju shpejguar se çdo të thotë kjo.

## Çfarë mjekimi do t'më jepet?

Klinicisti i juaj përgjegjës dhe një anëtar i stafit do të bisedojnë me ju lidhur me ndonjë mjekim të nevojshëm sipas mendimit të tyre. Në të shumtën e rasteve ju duhet të pranoni mendimin e tyre.

Ka rregulla të ndryshme për disa mjekime të veçanta, siç është terapia elektro-konvulsive (ECT). Nëse stafi mendon se ju keni nevojë për një nga këto mjekime të veçanta, do t'ju shpjegohen rregullat dhe do t'ju jepet një fletëpalosje tjetër.

## A mund të apeloj?

Po, ju mund të apelonit kundër vendimit për t'ju mbajtur në spital sipas paragrafit 2.

Për ta bërë këtë ju duhet të kërkonit nga Drejtuesit e Spitalit t'ju lejnë të dilni nga spitali. Këtë mund ta bëni në çdo kohë. Drejtuesit e Spitalit janë komision i veçantë i hapur brenda spitalit për të vendosur nëse njerëzit duhet të mbahen akoma në spital. Ata do të dëshirojnë të bisedojnë me ju para se të vendosin nëse ju lejnë të dilni nga spitali.

Ju mund t'ju shruani Drejtuesve të Spitalit në adresën:

Ose mund të pyetni një anëtar të stafit për t'ju ndihmuar t'i kontaktoni Drejtuesit e Spitalit.

Anëtari i juaj më i afërm familjar poashtu mund t'ju shkruaj Drejtuesve të Spitalit për t'ju thënë se ju ata dëshirojnë që t'ju lejohet dalja nga spitali. Kjo fletëpalosje ju shpjegon më poshtë se cilët janë anëtarët më të afërm të familjes tuaj. Nëse anëtari i juaj më i afërm familjar e bënë këtë, Drejtuesit e Spitalit duhet t'ju lejnë të dilni brenda 72 orëve, përveç nëse klinicisti i juaj përgjegjës ju thotë atyre se ju mund të jeni rrezik për vetëveten dhe për njerëzit tjerë nëse ju lejojnë të dilni nga spitali. Nëse ndodhë kjo, atëherë anëtari i juaj më i

afërm nuk do të mund të kërkoj nga Drejtuesit e Spitalit që t'ju lëshojnë nga spitali edhe për gjashtë muaj, nëse ju akoma mbaheni në spital në atë kohë.

Ju mund të kërkonit nga Tribunal që të pohoj se ju nuk duhet të mbaheni më në spital. Ju mund ta bëni këtë gjatë 14 ditëve të para të 28 ditëve që mund të mbaheni në spital.

## Ç'është Tribunali dhe çfarë ndodhë?

Tribunali është një kuadro e pavarur e cila mund të vendos nëse ju akoma keni nevojë për kujdestar. Ky kuadër do të mbajë një mbledhje me ju dhe me stafin që ju njeh juve. Kjo mbledhje quhet "seancë". Nëse doni ju mund të kërkonit nga një person të vjen në seancë për t'ju ndihmuar. Para seancës, anëtarët e Tribunalit do të lexojnë raportin lidhur me ju dhe kujdestarinë tuaj. Njëri nga anëtarët e Tribunalit do të vijë të flas me ju.

Nëse doni të aplikoni tek Tribunali, ju mund t'i shkruani në adresën:

The Tribunals Service(Shërbimit i Tribunalit)

PO BOX 8793

5th Floor

Leicester

LE1 8BN

Tel. 0300 123 2201

Ju mund të kërkonit nga avokati t'i shkruaj Tribunalit për ju dhe t'ju ndihmoj në seancë. Autoriteti i shërbimeve sociale dhe shoqata e drejtësisë kanë një listë të avokatëve të specializuar për këtë çështje. Ju nuk duhet të paguani avokatin për këtë ndihmë. Ky shërbim është falas në bazë të skemës për Ndihmë Ligjore.

## Njoftimi i anëtarit më të afërn familjar

Një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si më të afërmin e familjes tuaj.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërt familjar. autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejtash ka me i afërmi familjar tuaj në lidhje me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërt familjar është:

Nëse ju nuk dëshironi që ky person të marrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni infermierit tuaj ose një anëtar të stafit.

## Ndërrimi i anëtarit më të afërm familjar

Nëse mendon se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet më i afërmi i familjes tuaj, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të konsideruar një person tjetër si më të afërmin tuaj familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

## Letrat e juaja

Të gjitha letrat e marruara gjatë qëndrimit tuaj në spital do t'ju dorzohen juve. Ju mund t'ju dërgoni letër çdonjërit, përveç ndonjërit që ka pohuar se nuk dëshiron të marrë letra nga ju. Letrat dërguar këtyre personave mund të ndalohen nga stafi i spitalit.

## Kodi Praktik

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thotë Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni , ju mund të kërkonit të shihni një kopje të Kodit.

## Si të ankohem?

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju jepen informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Nëse mendoni se procedura e ankimit nuk mund t'ju ndihmon, ju mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komisioni i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

## Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkonit nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkonit një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.